



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 55/2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 87/2018 “PËR
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PARLAMENTAR “PËR NDJEKJEN E ZBATIMIT
TË LIGJIT NR. 12/2018 “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETËTIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE
SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT””, NË PËRBËRJE
TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË KUVENDIT PËR SIGURINË
KOMBËTARE”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, e
55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 87/2018 “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit për Sigurinë Kombëtare” bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Myslim Murrizi caktohet Zëvendëskryetar.
2. Deputetët Alban Zeneli dhe Ylli Shehu caktohen anëtarë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 8.5.2019